



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 78/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina- Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Aritech” Sh. p. k- Livaxhe, kundër njoftimit për anulim të kontratës lidhur e aktivitetit të prokurimit me titull: “Blerja e Kompjuterëve” me nr. prok. 231/17/003/136, iniciuar nga AK-/Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës/ më datën 07.04.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Aritech” Sh. p. k- Livaxhe lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja e Kompjuterëve” me nr. prok. 231/17/003/136, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues / Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës /.

II. Anulohet, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, me titull: “Blerja e Kompjuterëve” me nr. prok. 231/17/003/136 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues / Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës / si i pa bazuar, dhe lënda të kthehet në **Ri –Vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me këtë ligj;

V. Me qenë se pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues “Aritech” Sh. p. k- Livaxhe, janë të qëndrueshme, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:21.02.2017. Hapja e ofertave është bërë me dt:02.03.2017, ku kanë marr pjesë tre operator ekonomik. Njoftimi për anulim të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:06.03.2017. Kundër njoftimit për anulim të kontratës të aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik “Aritech” Sh. p. k- Livaxhe me dt:06.03.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues. Me dt:07.03.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Aritech” Sh. p. k- Livaxhe, Operatori ekonomik ankues “Aritech” Sh. p. k- Livaxhe, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 16 mars 2017 me nr. 75/17 kundër njoftimit për anulim të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Blerja e Kompjuterëve" me nr. prok. 231/17/003/136, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues AK- Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës duke pretenduar se autoriteti kontraktues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së.

- Neni 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 28.03.2017 ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues-teknik në raportin e dt: 31.03.2017, bazuar në sqarimet e cekura ne raportit të ekspertizës mendon që Autoriteti Kontraktues – Akademia e Shkencave dhe Arteve te Kosovës (ASHAK), për aktivitetin e prokurimit “Blerja e Kompjuterëve”, me nr. të Prokurimit: 231/17/003/136, rekomandojmë panelin shqyrtues që të ANULOJ Njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit i datës 16.03.2017, si dhe njëherit të kthehej në Ri-vlerësim këtë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datë: 04.04.2017, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues me datë: 03.04.2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 07.04.2017, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, ekspertët shqyrtues-teknik e OSHP-së, vëzhguesit nga OJQ “D Plus” u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi anulimin e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues OE: "Aritech" Sh.p.k ka deklaruar: AK ka pas kërkesën për minimumin e caktuar për kompjuter dh monitor, dhe sipas specifikave kemi bërë ofertë e cila ka dalë financiarisht më e lirë se ofertat tjera.

Specifikat janë plotësuar 100%, me gjithë atë kemi marr letër për eliminim të ofertës tonë, dhe janë cek dy arsye e para është se "keni ofrua procesor me shpejtësi më të ulët se ai i kërkuar".

Ne kemi bërë kërkesën për rishqyrtim dhe për këtë pikë kemi thënë "ajo çka është kërkuar Intel N30 50, performancën e këtij procesori janë frekuencat 1.6 Ghz, procesori jonë i ofruar është J1800 me frekuencë të punës 2.4 Ghz," në këtë rast frekuenca më madhe është më e mirë, do thotë tejkalohet. Soketi është i njëjti me atë të ofruar, po ashtu i njëjtë është numri i bërthamave.

Një prej autoriteteve që bënë vlerësimin e procesorëve është CPU Bnechmark dhe u jep pikë. E për këtë pikë procesori i ofruar ka 1022 , ndërsa procesi i kërkuar nga AK ka 891,do thotë qartësisht përmbush pikën për cilën jemi shpall të papërgjegjshëm.

Për pikën e dytë të eliminimit, refuzimi ka qenë për "monitori i ofruar është më i vogël se ai i kërkuar". Tek kërkesa e AK është kërkuar monitor ekuivalent me një model "Vieë Sonik VADD65S".Sipas kërkimeve specifikimeve bëhet fjalë për një model me dimensione 21.5 Inch TFT. E kemi marr linkun nga prodhuesi me specifika të plota që janë pjesë e dosjes, ndërsa kemi ofruar monitor Asus VS 228N i cili ka dimensione identike me monitorin e kërkuar.

Me këtë përgjigje kemi treguar se baza me cilën ne jemi shpall të papërgjegjshëm nuk qëndron dhe kemi bër kërkesën AK-së për rishqyrtim me informacione që për ne kanë qenë mjaftueshme të shpallemi fitues. Nga autoriteti kontraktues nuk është miratuar kërkesa jonë dhe nuk janë marr me sqarimet tona. Autoriteti kontraktues ka kërkuar arsye tjera në rishqyrtim, janë cekë pika të reja mirëpo prapë të paqëndrueshme, dhe është thënë "artikulli që ofertohet duhet ti saktësojnë plotësisht artikujt e ofertuar të cilat do ti sjellim po qe se shpërblehemi me kontratë".

Ne kemi saktësuar artikujt në specifikim, arsyeja tjetër është garancia duhet të mbulohet nga prodhuesi i pajisjeve. Ne në dokumentet që kemi ofruar shihet se, në specifikim të prodhuesit është garancioni 36 muaj, dhe nuk mungon asnjë element, del arsyetimi i AK është i paqëndrueshëm. Pas përgjigjes tonë

AK-së prapë ka pas një përgjigje tretë ku prapë na është refuzuar kërkesa me sqarime që nuk kanë qenë pjesë e eliminimit të parë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-ASHAK ka deklaruar:Sa i përket vlerësimit mendoj se komisioni ka kryer detyrën e vet. Herën e parë OE është eliminuar për procesor dhe monitor. Komisioni vlerësues ka konstatuar se monitori i kërkuar është 22 full, ndërsa i ofruar është 21.5 inç. Duke pas parasysh gjitha ankesat e palës lënda është kthyer në rishqyrtim ku është pa se mungon garancioni nga prodhuesi. Broshurë nuk kemi kërkuar mirëpo, kemi kërkuar garancion nga prodhuesi, ne gjithnjë kërkojmë që pajisjet të kenë garanci nga prodhuesi. Për këtë çështja ekziston se nëse ofertuesi mbyll kompaninë ne mbesim pezull me mirëmbajtje, diçka e tillë nuk është dhënë, pastaj në pikën dy shkruan "OE-të në kolonën artikulli që ofertohej duhet të saktësojnë plotësisht artikujt e ofertuar të cilët do të sjellin po qe se shpërblehen me kontratë. Çmimi më i ulët vlen vetëm kur plotësohet gjitha kushtet e caktuara me dosje të tenderit.

Gjatë prezantimit në seancë në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues cili deklaroi: Lidhur me specifika teknike do ja kaloja fjalën ekspertit teknik. Unë kam një sqarim për panelin lidhur me kriterin që cekur AK se është kërkuar të saktësisht, duhet sqaruar se ky nuk është kriter i matshëm i cili nuk mund të përdoret në vlerësim të ofertave, mirëpo është sqarim që mund të vendoset në dosje e cila ka të bëjë me implementimin e kontratë. Garancioni nga prodhuesi është shënuar te pjesa e çmimeve, dhe nuk ka qenë i caktuar si kriter për vlerësim të ofertave.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues-teknik i cili deklaroi: Qëndroj pranë raportit të ekspertizës, pasi konsideroj se OE ankues plotëson gjitha kërkesat e AK-së. Në njërin prej kërkesave AK ka përdor fjalën ekuivalent. Procesori për cilin është eliminuar OE siç ceku edhe vet, procesori i ofruar nga OE tejkalon kërkesat e AK-së. Lidhur me monitorin që është cek monitori Vieë Sonik VADD65S-3 LED 22 inç Full, kjo është kërkesa e AK-së. Nëse e sheh nga prodhuesi vet ky monitor është 21.5 inç dhe jo 22 inç. Te dosja e AK ceket edhe një fjali garancia tri vjet. Tjetër kund në dosje nuk është përmend garancia për cilën është eliminuar OE ankues.

Mirëpo ne shohim ofertën e OE të dy produktet që ka ofertuar i njëjti si çdo produkt tjetër që ofertohej përmban garancionin tre vjeçar prej prodhuesit. Këtë e ka në ofertën e vet OE në ofertën nga

prodhuesi. Lidhur me ofertën e OE ankues sipas dokumentacionit që kemi pas kosinderoj se OE plotëson kriteret e kërkuara nga AK.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues deklaroj: Ne qëndrojmë pranë ankesës dhe pretendimeve ankimore dhe kërkojmë që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: Ne qëndrojmë pranë vendimit të AK-së për anulim dhe i propozojmë panelit shqyrtues të njëjtin ta vërtetoj si të bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të parashtruesve të ankesave, sqarimeve dhe rekomandimit të ekspertit shqyrtues - teknik, parashtrësve të palëve në procedurë, konstaton se është e paqëndrueshme arsyeja e eliminimit të OE ankues "Aritech" Sh.p.k me arsyetimin se ka ofruar procesorin me shpejtësi më të ulët pasi që ky operator ekonomik ka ofruar performancat e procesorit J1800 me frekuencë të punës 2.4 Ghz, ndërsa kërkesë e AK-së ka qenë që procesori të jetë Intel N3050, çka do të thotë se OE ankues ka ofruar performanca të monitorit më të mira, pra ka ofruar shpejtësi më të madhe se sa ka qenë kërkesa e AK-së, prandaj kjo kërkesë është përmbushur madje është tejkaluar me përformancat e ofruara nga OE ankues.

Lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues se OE ankues ka ofruar monitor prej 21.5 inç pra më të vogël se sa ka kërkuar autoriteti kontraktues në dosje të tenderit prej 22 inç. Paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha faktet relevante dhe në ekspertizën e ekspertëve të OSHP-së, si dhe duke pasur parasysh sqarimet që u bënë në seancën dëgjimore u konstatua se nëse klikohet linku i prodhuesit me të cilin ka ofertuar OE ankues shihet dhe kuptohet qartë që specifikimet tekniket të ofruara nga OE ankues janë në përputhshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit respektivisht janë identike me monitorin e kërkuar.

Lidhur me arsyen tjetër të eliminimit se OE ankues nuk ka ofruar garancion nga prodhuesi, paneli shqyrtues konstaton se në dosje të tenderit gjendet garancioni në afat prej 36 muajve, prandaj edhe kjo arsye e eliminimit është e paqëndrueshme.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 59 të LPP-së dhe e ka anuluar këtë aktivitet pa ndonjë bazë ligjore.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në atë që u tha si më lart konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës"

1x1 OE "Aritech" Sh. p. k- Livaxhe

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.